



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIJA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	
Dep.	
Dep.	<u>2-D/DPK</u>
Nr. i faq.	
Broj stranica	<u>02</u>
Nr. pages	
Nr. Prot.	<u>01-2827/14</u>
Br. Prot.	
Prot No	
Data	
Datum	<u>11.08.2014</u>
Date	
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (parografi 1.1), nenit 5 (parografi 1 pika 1.5), nenit 18 (parografi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (parografi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.08.2014, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbylllet rasti me nr. AKK – 03-3297/13, për z. Ibrahim Arslan – zëvendës i Avokatit të Popullit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-3297/13, për z. Ibrahim Arslan – zëvendës i Avokatit të Popullit, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

Në këtë rast zyrtari i lartë z. Arslan, është hetuar për situatë të konfliktit të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik si zëvendës i Avokatit të Popullit dhe njëkohësisht pronar i vetëm në biznesin privat D.P.Z. "Picolo".

Ai fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin të procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit. Më pas, z. Arslan është takuar me zyrtarët e Agjencisë për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t'i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet t'i bëj, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

z. Arslan, është bindur për kufizimin si pronar i vetëm në biznesin privat (zotërimi aktiv i aksioneve ose pjesëve në kapital) dhe ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për ti bërë ndryshimet e nevojshme për të shmangur konfliktin e interesit.

Mirëpo, ai nuk i ka kryer ndryshimet në afatin e premtuar, prandaj Agjencia i ka dërguar shkresën e dytë (shkresën paralajmëruese) me të cilën i është kërkuar që në afatin ligjor të shmang konfliktin e interesit.

Ndërkohë, i njëjtë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 2784/14) me të cilën vërtetohet se ai ka emëruar një "person të besueshëm" në funksionin e personit të autorizuar, ashtu siç e parasheh edhe ligji. Me këtë, zyrtari i lartë z. Ibrahim Arslan, ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./zpj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

Hasan Preteni



*Preteni*